

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5460
E mërkurë, 25 prill 2018
çmimi 0.40 €

Nis ndërtimi i rrugës Deçan - Plavë

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka bërë me dije se projekti i rrugës Deçan - Plavë do të përfundojë në vitin 2020 si dhe kostoja e tij do të jetë 12 milionë euro. Lekaj ka theksuar se kjo rrugë do të ketë ndikim pozitiv shumëdimensional ■ **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**HARADINAJ: KOSOVA
I PËRKET FAMILJES
EVROPIANE** F. 2

**MINISTRI BYTYQI
PARALAJMËRON SE EDUKIMI
MEDIAL DO TË JETË LËNDË
ZGJEDHORE** F. 6

**KOSOVA, SHEBULL
SUKSESI PËR IMUNIZIMIN
E FËMIJËVE** F. 6

EKONOMI

**75 PËR QIND E UJËRAVE NË
KOSOVË KEQMENAXHOHEN** F. 9

**EKSPORTI I KOSOVËS
NË MARS MBULOI IMPORTIN
10.4 PËR QIND** F. 8

KULTURË



**VDES AKTORI ART KURTI,
POLICIA DYSHON SE ËSHTË
VETËVRARË** F. 14

SPORT

**REXHA PREFERON TITULLIN
PARA 'KËPUCËS SË ARTË'** F. 14

**BAYERNI, PËR HAKMARRJE
KUNDËR REALIT** F. 14

FLET PËR "EPOKËN E RE", VALON MURATI ■ **FAQE 4-5**

Platforma për dialog ta ketë brenda parimin e reciprocitetit me Serbinë

- Kosovës i duhet platformë vetëm për bisedimet me Serbinë, për çështjet e tjera duhet konsensus



Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, i cili në Qeverinë e kaluar ka qenë ministër i Diasporës, ka thënë se Kosovës i duhet platformë vetëm për bisedimet me Serbinë, kurse për çështjet e tjera duhet konsensus. Ai ka bërë me dije se

platforma e Qeverisë për finalizimin e dialogut me Serbinë nuk i plotëson kushtet të quhet platformë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Murati ka thënë se ajo platformë është një shkresë në të cilën janë vendosur disa objektiva,

por nuk tregohet se si do të arrihen ato. Sipas tij, çfarëdo platforme e bisedimeve me Serbinë do të duhej ta përmbante në vete parimin e reciprocitetit në marrëdhëniet me Serbinë, që do të mund të shtrihej në dy rrafshë

Opozita: Dialogun me Serbinë ta udhëheqë Qeveria, jo presidenti

Përfaqësuesit e subjekteve opozitare kanë kërkuar që dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë të udhëhiqet nga Qeveria, jo nga presidenti. Por zyrtarët e koalicionit qeverisës kanë thënë se

Kuvendi vendos se kush do ta drejtojë këtë proces. Këto komente ata i kanë bërë në tryezën me temë "Në kërkim të konsensusit: Dialogu Kosovë - Serbi dhe perspektiva zgjeruese e BE-së".

Megjithatë, të pranishmit kanë kërkuar arritjen e konsensusit për fazën finale të dialogut, duke thënë se epilogu i këtij procesi duhet të jetë njohja reciproke në mes dy vendeve ■ **FAQE 7**



Tryezat e partive politike vlerësohen blerje kohe

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) sot (e mërkurë) në ambientet e Kuvendit të Kosovës do ta organizojë

tryezën me partitë e tjera politike, ku çështje diskutimi do të jetë gjendja e krijuar në vend ■ **FAQE 3**



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curtëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sut.styro@yukon.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Pristinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, po merr pjesë në Samitin e Bërdos

Haradinaj: Kosova i përket familjes evropiane

Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Kosova ka dëshmuar përkushtimin e saj për marrëdhënie të mira me vendet fqinje dhe synon të ketë raporte të mira fqinjësore edhe me Serbinë. Ai ka thënë se Kosova i përket familjes evropiane, familjes së vlerave perëndimore dhe në këtë rrugëtim nuk ka kthim prapa

PRISHTINË, 24 PRILL - Në Samitin e Bërdos që po mbahet në kuadër të SEECP (Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore), kryeministri Ramush Haradinaj ka theksuar përkushtimin dhe angazhimin e Kosovës në forumet dhe iniciativat e bashkëpunimit rajonal, me qëllim të arritjeve të standardeve të duhura për Kosovën dhe rajonin drejt integritimit të plotë në strukturat evropiane. Kryeministri Haradinaj ka falënderuar Slloveninë dhe kryeministrin e saj Miro Cerar për kryesimin e këtij viti të SEECP-së dhe për rolin lehtësues në forcimin e bashkëpunimit rajonal. "Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, i themeluar mbi parimet e vizionit për të ardhmen dhe për barazinë, po jep rezultate konkrete në procesin e përafritimit dhe integritimit të vendeve të Evropës Juglindore, duke ruajtur njëkohësisht vlerat e përbashkëta shoqërore, historike dhe gjeografike. Kosova ka dëshmuar përkushtimin e saj për marrëdhënie të mira me vendet fqinje, Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe po vazhdon përpjekjet për të vendosur raporte të mira fqinjësore edhe me Serbinë. Kosova i përket familjes evropiane, familjes së vlerave perëndimore dhe në këtë rrugëtim nuk ka kthim prapa", ka thënë Haradinaj në fjalën e tij në këtë

samit.

Kryeministri Haradinaj foli edhe për qëndrimet dhe angazhimet e shtetit të Kosovës për forcimin e bashkëpunimit dhe besimit rajonal, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, stabilitetin dhe sigurinë, marrëdhëniet e zgjeruara ekonomike, luftën kundër krimit të organizuar dhe luftën kundër terrorizmit.

SEECP është një proces rajonal i institucionalizuar i koordinuar nga shteti që mban kryesinë në detyrë. Misioni i tij kryesor është ta nxisë perspektivën e BE-së për Evropën Juglindore dhe të punojë drejt lidhjes, sigurisë, stabilitetit dhe përparimit ekonomik të rajonit. "Kosova po e dëshmon përkushtimin e saj për ndërtimin e raporteve korrekte me fqinjët dhe vendet e Evropës Juglindore, duke qenë pjesë dhe kontribuar në nismat dhe angazhimet e përbashkëta, në të mirë të paqes dhe të ardhmes", është shprehur kryeministri Haradinaj.

Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) filloi në vitin 1996 në Sofje me synimin për ta forcuar bashkëpunimin dhe besimin rajonal. Pjesëmarrës në SEECP janë: Shqipëria, Bosnjë e Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Hungaria, Kosova, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Turqia dhe Sllovenia.



Kosova do të jetë kryesuese e SEECP në vitin 2019-2020.

Haradinaj: Kroacia, aleate në rrugëtimin tonë euroatlantik

Kosova dhe Kroacia ndajnë vlera të përbashkëta nga e kaluara historike dhe nga e ardhmja evropiane. Kështu ka thënë kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në takim bilateral që zhvilloi të martën me kryeministrin e Kroacisë, Andrej Plenković. "Duke marrë për bazë shembullin kroat të integritimit, Kosova mund t'i nxjerrë përvojat më të mira në procesin e integritimit dhe në këtë frymë ne do të bashkëpunojmë ngushtë me Kroacinë, në përafritimin me familjen evropiane dhe me NATO-n", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se Republika e Kroacisë ka dhënë mbështetje të fuqishme për Kosovën në rrugën e forcimit dhe konsolidimit të shtetësisë dhe për këtë popull dhe Qeveria e Kosovës janë mirënjohës.

Haradinaj ka kërkuar mbështetjen e Kroacisë për Kosovën edhe më tutje për shtimin e numrit

të njohjeve, anëtarësimin në strukturat euroatlantike dhe në organizata ndërkombëtare. Ndërsa kryeministri i Kroacisë, Andrej Plenković, ka thënë se shteti kroat do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në rrugën e saj eurointegruese.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në Bërdo është takuar edhe me homologun e tij nga Mali i Zi, Dushko Marković, me të cilin ka biseduar për hapjen e një kapitulli të ri të bashkëpunimit. "Vazhdimësi e dialogut me kryeministrin e Malit të Zi, për nismat rajonale që na afrojnë si dhe për projektet infrastrukturore që forcojnë lidhjet ndërmjet dy shteteve tona. Me homologun Dushko Marković u pajtuam që rajoni ynë ka hapur një kapitull të ri bashkëpunimi dhe se rezultatet pozitive për dy shtetet tona dhe tërë rajonin janë të sigurta", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Rama nis vizitën dyditore në Berlin

TIRANË, 24 PRILL - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka nisur vizitën dyditore në Berlin. Momenti kryesor i kësaj vizite do të jetë takimi me kancelaren Angela Merkel dhe biseda do të fokusohet te pritshmëritë për një vendim pozitiv për hapjen e bisedimeve për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në ditën e dytë, kryeministri Rama do të shkojë edhe në Bundestagun gjerman, institucioni që do ta marrë vendimin për hapjen ose jo të

negociatave. Është planifikuar një seancë bashkëbisedimi mes kryeministrit dhe Komisionit të Jashtëm në Bundestag. E veçanta është se ky Komision drejtohet nga Gunther Krichbaum, ai që ditët e fundit është vënë në qendër të një përplasjeje të re mes kryetarit të Partisë Demokratike, Lulzim Basha dhe kryeministrit Rama. Në fundjavë, Basha akuzonte kreun e Qeverisë se po financonte një fushatë denigruese me shënjestër kreun e Komisionit për

Çështjet e Evropës në Bundestag. Deklarata e Bashës shkaktoi reagimin e kryeministrit përmes një postimi në "Facebook". Sot (e mërkurë) Rama dhe deputeti gjerman do të jenë ballë për ballë për t'i përplasur argumentet e tyre.

Po kush është Gunther Krichbaum, deputeti i partisë së Merkelit, që disa herë ka trazuar politikën shqiptare? Ai mban poste shumë të rëndësishme në partinë e kancelares, britanikët e

quajnë "qen sulmi i Merkelit", etiketim që i ka mbetur nga koha e Brexit. Ai mban disa tituj dhe vlerësime, ndërsa në Shqipëri i janë bërë shumë akuzat duke e quajtur antishqiptar, pasi deklaronte se nuk është koha për Shqipërinë dhe se kërkesa e Shqipërisë për hapjen e negociatave është e papjekur, ka njoftuar "Top Channel".

Akuzohej si proserb dhe për standarde të dyfishta me qëndrimin pro integritimit të Serbisë, edhe pse



në atë vend nuk ka nisur një reformë në drejtësi, apo kur kërcënonte Kroacinë që të mos bëjë pengesë për Beogradin. Akuzohet edhe për qëndrime proruse duke anitur deri aty sa të thuhet se është në borderotë e Vladimir Putinit.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka mbajtur tryezën me temë "Në kërkim të konsensusit: Dialogu Kosovë - Serbi dhe perspektiva zgjeruese e BE-së"

Opozita: Dialogun me Serbinë ta udhëheqë Qeveria, jo presidenti



Përfaqësuesit e subjekteve opozitare kanë kërkuar që dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë të udhëhiqet nga Qeveria, jo nga presidenti. Por zyrtarët e koalicionit qeverisës kanë thënë se Kuvendi vendos se kush do ta drejtojë këtë proces. Këto komente ata i kanë bërë në tryezën me temë "Në kërkim të konsensusit: Dialogu Kosovë - Serbi dhe perspektiva zgjeruese e BE-së". Megjithatë, të pranishmit kanë kërkuar arritjen e konsensusit për fazën finale të dialogut, duke thënë se epilogu i këtij procesi duhet të jetë njohja reciproke në mes dy vendeve

EPOKA
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 24 PRILL - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) të martën ka mbajtur tryezën me temë "Në kërkim të konsensusit: Dialogu Kosovë - Serbi dhe perspektiva zgjeruese e BE-së", ku të pranishmit kanë shprehur mendime të ndryshme sa i përket ecurisë së këtij procesi. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Glauk Konjufca, ka thënë se kjo lëvizje është për konsensus për mbrojtjen e interesit të Kosovës, por jo për konsensus për krijimin e "Zajednicës". Ai ka kërkuar që dialogu të udhëhiqet

nga Qeveria e jo nga presidenti ndërsa Kuvendi, sipas Konjufcës, duhet të jetë në epiqendër të këtij zhvillimi. Ai ka theksuar se Kosova duhet të kërkojë që të mos pengohet në shtrirjen e sovranitetit të plotë në veri dhe në procesin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare. "Nuk konsideroj se konsensusi është gjëja më e rëndësishme. Konsensusi ka kuptim kur është për mbrojtjen e interesit të Kosovës. Nëse duhet konsensus për 'Zajednicën', Lëvizja Vetëvendosje nuk është aty. Jemi për konsensus për mbrojtjen e interesit shtetëror. Jo çdo agjendë institucionale është duke e

mbrojtur interesin e shtetit. Ajo që është më e rëndësishmja ka të bëjë me një platformë të Kosovës për t'i mbrojtur interesat e veta", është shprehur Konjufca, duke shtuar se Serbia dëshiron të imponojë fazë të re të kompromiseve. Edhe deputeti i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka thënë se dialogu nuk duhet të udhëhiqet nga presidenti Thaçi për shkak të trashëgimisë së tij në këtë proces.

Sa i përket mbështetjes së fazës së ardhshme të dialogut, ai ka thënë se Nisma ende nuk ka një qëndrim. "Mendoj se nuk duhet Thaçi ta udhëheqë dialogun. Të gjithë e dimë se rezultatet e

dialogut nuk janë të kënaqshme. Kemi problem me njeriun, jo me institucionin. Është iluzion të mendosh se, nëse ke ndërruar pozitën, e ke ndërruar edhe qasjen. Nuk e di si do të zhvillohen bisedimet e brendshme. Nuk kam qëndrim të Nismës se a do të mbështeten apo jo", ka thënë Sherifi.

Ndërsa deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ahmet Isufi, ka thënë se Kuvendi vendos se kush duhet ta udhëheqë dialogun. Sipas tij, kushdo që udhëheq këtë proces e ka për detyrë të japë llogari në Kuvend. "Kërkohet që Kuvendi i Kosovës të jetë institucioni ku jepet llogari për procesin e dialogut. I takon Kuvendit se si do të përcaktohet dhe kush do ta udhëheqë këtë dialog. Detyrat të ndahen mes institucioneve, por përgjegjësia të mbetet në Kuvendin e Kosovës. Me Kushtetutë mund të krijohet Asociacioni i cili s'ka kompetenca ekzekutive. Jemi këtu që procesi të mos devijojë. Serbia nuk duhet ta pengojë Kosovën të anëtarësohet në institucione ndërkombëtare.

Këtu duhet të këmbëngulim. Edhe pozita e opozita kanë përgjegjësi dhe duhet të jemi në proces dhe të japim kontribut të gjithë që ky dialog të përfundojë me njohje", ka theksuar Isufi.

Ndërkaq kryeredaktori i gazetës "Koha ditore", Agron Bajrami, ka thënë se duhet të ndërtohet një platformë konsensuale e cila do të reflektonte jo vetëm synimet e Kosovës në dialog me Serbinë, por edhe synimet në procesin e integritimit evropian. "Mendoj se nuk është shfrytëzuar procesi i dialogut dhe tani është momenti të ndërtojmë një platformë për fazën finale. Kosova ka nevojë ta ndërtojë konsensusin rreth dialogut me Serbinë. Ai konsensus duhet të prodhojë një platformë e cila reflekton jo vetëm synimet e Kosovës në dialog me Serbinë, por edhe synimet në procesin e integritimit evropian", ka deklaruar Bajrami, duke shtuar se procesi i integritimit të Kosovës dhe i Serbisë në Bashkimin Evropian është i varur nga rezultati i dialogut.

IPK-ja nis hetimet për policët që arrestuan Marko Gjuriqin

PRISHTINË, 24 PRILL - Pjesëtarët e Policisë së Kosovës që morën pjesë në arrestimin e shefit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq, do të hetohen nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK). Hetimet kanë filluar pas ankesës që e ka bërë në inspektorat zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Milan Radojeviq. Nisjen e grumbullimit të informacioneve e ka konfirmuar për "Radion Evropë e Lirë" zëdhënësi i IPK-së, Arbër Beka. "Pas ankesës së zëvendësministrit të Punëve të Brendshme ka nisur grumbullimi i informacioneve në lidhje me

dyshimet për shkelje eventuale të detyrës nga zyrtarët policorë", ka thënë Beka.

Pjesëtarët e Policisë së Kosovës do të hetohen lidhur me dyshimet për tejkallim të përdorimit të forcës ditën kur u arrestua Marko Gjuriq. Inspektorati Policor i Kosovës ka njoftuar se do të ndërmerren veprime të tjera hetimore varësisht nga të gjeturat e këtij procesi të grumbullimit të informacioneve dhe në konsultim me prokurorin kompetent.

Kryetari i Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Haxhi Shala, ka thënë se Inspektorati

Policor i Kosovës e ka për obligim t'i hetojë të gjitha dyshimet, por ka deklaruar se në Komision ende nuk kanë pranuar raport për atë që ka ndodhur me rastin e arrestimit të shefit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq. Marko Gjuriq u arrestua më 26 mars të këtij viti në Mitrovicën Veriore. Njësitë Speciale të Policisë së Kosovës kryen arrestimin pasi atij paraprakisht iu kishte refuzuar kërkesa për vizitë në Kosovë. Pas arrestimit, Gjuriq u soll në Prishtinë dhe, pas qëndrimit rreth njëorësh, ai u deportua për në Serbi.



Flet për "Epokën e re", Valon Murati

Platforma për dialog ta ketë brenda

- Kosovës i duhet platformë vetëm për bisedimet me Serbinë, për çështjet e tjera duhet konsensus

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, i cili në Qeverinë e kaluar ka qenë ministër i Diasporës, ka thënë se Kosovës i duhet platformë vetëm për bisedimet me Serbinë, kurse për çështjet e tjera duhet konsensus. Ai ka bërë me dije se platforma e Qeverisë për finalizimin e dialogut me Serbinë nuk i plotëson kushtet të quhet platformë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Murati ka thënë se ajo platformë është një shkresë në të cilën janë vendosur disa objektiva, por nuk tregohet se si do të arrihen ato. Sipas tij, çfarëdo platforme e bisedimeve me Serbinë do të duhej ta përmbante në vete parimin e reciprocitetit në marrëdhëniet me Serbinë, që do të mund të shtrihej në dy rrafsh

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 24 PRILL - Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka kritikuar platformën shtetërore për finalizimin e dialogut të Kosovës me Serbinë. Ai ka thënë se ky dokument është një shkresë që aspak nuk i plotëson kriteret për të qenë platformë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Murati ka thënë se çfarëdo platforme e bisedimeve me Serbinë do të duhej të përmbante në vete parimin e reciprocitetit në marrëdhëniet me Serbinë. "Çfarëdo platforme e bisedimeve me Serbinë do të duhej ta përmbante në vete parimin e reciprocitetit në marrëdhëniet me Serbinë. Ky reciprocitet do të mund të shtrihej në dy rrafsh. E para, të gjenden zgjidhje reciprokisht të njëjta për shqiptarët në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë me ato që do të aplikohen në Leposaviq, Zveçan dhe Zubin-Potok, në anën tjetër të zbatohet reciprociteti në të drejta si për shqiptarët që jetojnë kudo në Serbi me ato të serbëve në Kosovë", ka thënë Murati. Ai ka paralajmëruar se nëse nuk zbatohet ky parim në këto bisedime, Kosova rrezikohet të bëhet një shtet i dështuar. "Përndryshe, nëse ne vazhdojmë të flasim vetëm për Kosovën, nëse ne vazhdojmë të bëjmë

kompromis pas kompromisi, po e shndërrojmë Kosovën jo vetëm në një shtet jofunksional të varur në tërësi nga pakica serbe dhe indirekt nga Beogradi, por po rrezikojmë ta bëjmë edhe atë që njihet si failed state, apo shtet i dështuar", është shprehur ai.

Kryetari i LB-së ka folur edhe për iniciativat e PDK-së dhe LDK-së për të ndërtuar një konsensus nacional për çështjet e rëndësishme shtetërore, duke i mirëpritur ato. Sipas tij, Kosova duhet të ketë platformë vetëm për bisedimet, kurse për të tjerat çështje nevojitet vetëm konsensus. "Është për t'u përshëndetur çfarëdo nisme për të arritur konsensus kombëtar e shtetëror për temat që vërtet na prekin si shtet e shoqëri. Sidoqoftë, ditët e fundit thuajse ka filluar një garë se kush po prin në këto nismat për platforma e konsensus. Letra e z. Veseli, kryetarit të PDK-së, kishte disa defekte serioze. Unë mendoj se Kosovës i duhet platformë vetëm për bisedimet me Serbinë, përderisa për çështjet e tjera duhet konsensus, sidomos për reformën zgjedhore", ka thënë Murati.

"Epoka e re": Z. Murati, Qeveria e Kosovës javën e kaluar e ka miratuar platformën për finalizimin e dialogut me Serbinë. Cili është qëndrimi juaj për këtë platformë?

Murati: Lëvizja për Bashkim e



ka bërë publike se ky dokument është një shkresë që aspak nuk i plotëson kriteret e të qenit një platformë. Personalisht m'u duk si një rezolutë e thjeshtë e Kuvendit të Kosovës. Në këtë shkresë vendosen disa objektiva, si ajo e arritjes së një marrëveshjeje finale në mes të Kosovës dhe Serbisë, njohja reciproke, ulësja në OKB, shpejtimi i integritit në NATO dhe BE (këto dy të fundit ishin krejt të palogjikshme në këtë tekst) etj. Se cili do të jetë pozicioni ynë për të arritur këto objektiva, se cilët janë hapat për t'i arritur këto objektiva, se cilat do të jenë kushtet tona, ky dokument nuk tregon. Për më tepër, aty, në mënyrën më të papërgjegjshme, vazhdon të mos flitet për shqiptarët e Kosovës Lindore, gjë që shpreh edhe një herë mentalitetin

joshtetëror të këtyre faktorëve. Kështu, logjikshëm, në mënyrë implicite del se këto objektiva do të arrihen duke biseduar me Serbinë vetëm për çështjet e brendshme të Kosovës dhe për pakicën serbe në Kosovë. Ne mendojmë se kjo ka qenë një qasje e gabuar që prej fillimit të dialogut me Serbinë, dhe kjo e ashtuquajtur platformë, është vetëm vazhdimësi e logjikës së njëjtë. Nuk ka asgjë të ndryshme në këtë dokument nga ajo që kemi parë në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë deri më tani.

"Epoka e re": Shumë shpejt kjo platformë do të diskutohet edhe në Kuvendin e Kosovës, ku pritet ta marrë formën përfundimtare. Me çfarë duhet të plotësohet kjo platformë?

Murati: Çfarëdo platforme e

bisedimeve me Serbinë do të duhej ta përmbante në vete parimin e reciprocitetit në marrëdhëniet me Serbinë. Ky reciprocitet do të mund të shtrihej në dy rrafsh. E para, të gjenden zgjidhje reciprokisht të njëjta për shqiptarët në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë me ato që do të aplikohen në Leposaviq, Zveçan dhe Zubin-Potok, në anën tjetër të zbatohet reciprociteti në të drejta si për shqiptarët që jetojnë kudo në Serbi me ato të serbëve në Kosovë, duke përfshirë në këtë situatë edhe vendet e garantuara në Kuvendin e Serbisë dhe të drejtën e vetos, ashtu siç e kanë serbët në Kuvendin e Kosovës. Pastaj të zbatohen të njëjtat parime të ndërtimit dhe funksionimit të gjyqësorit, policisë e deri tek asociacioni i

parimin e reciprocitetit me Serbinë



komunave me shumicë shqiptare. Përndryshe, nëse ne vazhdojmë të flasim vetëm për Kosovën, nëse vazhdojmë të bëjmë kompromis pas kompromisi, po e shndërrojmë Kosovën jo vetëm në një shtet jofunksional të varur në tërësi nga pakica serbe dhe indirekt nga Beogradi, por po rrezikojmë ta bëjmë edhe atë që njihet si failed state, apo shtet i dështuar.

"Epoka e re": Parimisht opozita e ka kundërshtuar këtë platformë duke e cilësuar të varfër. Cili duhet të jetë qëndrimi i opozitës ndaj këtij dokumenti?
Murati: Opozita do të duhej të angazhohej për një konsensus shtetëror dhe kombëtar, i cili do të bazohej mbi principin e reciprocitetit, të cilin e elaborova më lart. Për të qenë i sinqertë,

kam shumë pak shpresa se kjo do të ndodhë. LDK-ja, në njërin anë, konceptualisht jo vetëm se nuk dallon nga Qeveria aktuale, por ajo qoftë kur ka qenë në opozitë më herët, qoftë kur ka qenë në pushtet, ka ndjekur të njëjtën vijë politike sa i përket dialogut me Serbinë. Dialog vetëm për çështje të brendshme të Kosovës, kompromise, me shpresën se mos Serbia po na njeh në fund. Me asgjë deri më tani LDK-ja nuk ka dëshmuar se ka ndryshuar qasje. Në anën tjetër, LV-ja është krejtësisht e çorientuar në raport me dialogun dhe qëndrimet e saj janë krejtësisht jokonsistente. Ky çorientim vjen edhe për shkak të faktit se kundërshtimin shumëvjeçar të dialogut me Serbinë përmes parullave "Jo negociata, Vetëvendosje" dhe

të një sërë kushtesh për të bërë dialogun, duke iu afruar pushtetit, e ndërruan në "dialog të brendshëm me serbët". Tani kryetari i LV-së, z. Kurti, erdhi me idenë e tri fazave që duhet të realizohen para se të fillojë dialogu me Serbinë. Është pak e vështirë në këto rrethana të dihet cili në të vërtetë është pozicioni i vërtetë i LV-së sa i përket dialogut me Serbinë?! A është për këtë dialog me kushtet e vjetra a jo? A është për dialog vetëm me serbët lokalë? Apo është për dialog me Serbinë pas realizimit të tri fazave paraprake? Në këto rrethana ende nuk po shoh dritë në fund të tunelit, dhe jemi duke rrezikuar shumë që të lëshojmë një rast të mirë për ta përmbyllur ciklin e konfliktit shqiptaro-serb duke adresuar çështjet e mbetura, sidomos çështjen e Kosovës Lindore, dhe tri komunave serbe në veriun e Kosovës, duke hapur kështu mundësitë që Kosovën ta shndërrojmë në shtet funksional.

"Epoka e re": PDK-ja dhe LDK-ja kanë propozuar dy iniciativa të ndara përmes të cilave synohet arritja e një konsensusi nacional për çështjet e mëdha. Si i keni parë këto iniciativa?

Murati: Është për t'u përshëndetur çfarëdo nisme për të arritur konsensus kombëtar e shtetëror për temat që vërtet na prekin si shtet e shoqëri. Sidoqoftë, në ditët e fundit thuhet se filluar një garë se kush po prin në këto nisma për platforma e konsensus. Letra e z. Veseli, kryetarit të PDK-së, kishte disa defekte serioze. Unë mendoj se Kosovës i duhet platformë vetëm për bisedimet me Serbinë, përderisa për çështjet e tjera duhet konsensus, sidomos për reformën zgjedhore. P. sh., për ushtrinë ka konsensus për krijimin e saj. Çështja është a po realizohet me ndryshime kushtetuese apo me ligj. Andaj pse duhet të kemi platformë e cila do të përmbante këtë çështje?! Njëjtë është me agjendën e integritetit evropian, për të cilën ka konsensus të gjerë. Pse duhet të ketë platformë që garanton luftimin e krimit dhe korrupsionit? Për këtë çështje duhet vetëm vullnet politik i atyre që janë në krye të Qeverisë. Në anën tjetër kemi edhe çështjen e Asociacionit, e cila në këto rrethana na lë pak hapësirë veprimi. Asociacionin është miratuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2013 dhe gjithashtu Gjykata Kushtetuese e ka vulosur ekzistencën e tij me vendimin e vitit 2016. Vetëm ndryshimi konceptual i

bisedimeve me Serbinë do të mund ta ndryshonte realitetin sa i përket Asociacionit. Në anën tjetër, kemi ftesën e kryetarit të LDK-së, z. Mustafa, për një takim ndërpartiak për të biseduar për çështjet e rëndësishme të vendit, parimet se si do të trajtohen këto çështje si dhe për caktimin e datës së zgjedhjeve. Ajo që ndihet në këtë ftesë, është përpjekja për të zënë një pozicion sa më të mirë në opinionin publik në momentin e dhënë. Unë besoj se idetë për organizimin e tryezave të tilla janë të dobishme, porse organizimi praktik i tyre duhet të vijë pas një pajtimi paraprak të subjekteve politike, në mënyrë që askush të mos ndihet se po e merr flamurin në këtë drejtim.

"Epoka e re": Dy subjektet më të mëdha opozitare, LDK-ja dhe LV-ja, kanë paralajmëruar mundësinë e ngritjes së një mocioni mosbesimi ndaj Qeverisë për ta çuar vendin në zgjedhje të parakohshme.

Është momenti i duhur për një veprim të tillë?

Murati: Është krijuar një praktikë jo e mirë, që kushdo që është në opozitë, orë e çast të kërkojë që vendi të shkojë në zgjedhje. Është e vërtetë se ne kemi një Qeveri me shumë pak funksionalitet dhe me krizë të madhe numrash. Është e vërtetë se kemi një Qeveri krejtësisht të varur nga deputetët e Listës Serbe. Megjithatë, çfarëdo zgjedhesh të shpejta, nuk garantojnë stabilitet për Qeverinë e ardhshme. Para çfarëdo vendimi për zgjedhje të ardhshme, partitë politike duhet të arrijnë një konsensus për reformën zgjedhore. Çfarëdo zgjedhesh në nguti, e pa reformë zgjedhore, do të vazhdojnë të deformojnë jo vetëm vullnetin e votuesve, por edhe vetë sistemin e vlerave brenda subjekteve politike. Rrjedhimisht, do të kemi çdoherë e më pak institucione legjitime, sepse sistemi aktual krijon hapësirë të madhe për manipulime brenda listave të partive politike.



Ministri Bytyqi paralajmëron se edukimi medial do të jetë lëndë zgjedhore

EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 24 PRILL - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ka paralajmëruar se edukimi medial do të jetë lëndë zgjedhore në shkollat e vendit. Këtë konstatim ai e ka dhënë të martën në konferencën me temë "Konsultimet nacionale mbi politikën dhe strategjitë për edukimin mbi median dhe informacionin", e cila është organizuar nga Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) në partneritet me Zyrën për Qeverisje të Mirë në kuadër të

Zyrës së Kryeministrit dhe me mbështetje të UNESCO-s dhe të BE-së.

Ministri Bytyqi ka pohuar se konsultimet e tilla synojnë një debat gjithëpërfshirës për Edukimin mbi Median dhe Informacionin (EMI) si dhe për nevojën e inicimit të hartimit të një kornize strategjike për integrimin e konceptit të EMI-së në sistemin arsimor formal dhe joformal të Kosovës. "Përfshirja e lëndës edukimi medial në sistemin arsimor në Kosovë është i një rëndësie të veçantë dhe hap pozitiv për edukimin e të rinjve tanë në këtë fushë. Nxënësit tanë kanë nevojë



të kenë një qasje shumë më të drejtë në edukimin medial sepse nuk është vetëm çështje e fitimit të shkathtësive të të rinjve tanë për përdorimin e mediave, por rreziku për t'u përballur me informatat e pakontrolluara të cilat vijnë në kohën e zhvillimit të hovshëm të teknologjisë", ka thënë ministri Bytyqi.

Ai ka shtuar se edukimi medial është pjesë e kurrikulave, por jo në hapësirën në të cilën do të duhej të ishte. "Andaj edhe duhet një angazhim i të gjithë faktorëve në këtë drejtim si parakusht për shoqëri të dijes dhe media të lira", ka thënë Bytyqi.

Kosova, shembull suksesi për imunizimin e fëmijëve

EPOKA E RE Faton DERMAKU

PRISHTINË, 24 PRILL - Kosova është ndër 42 vendet që kanë ndërprerë me sukses përhapjen endemike të fruthit për faktin se për 15 vjet nuk ka pasur raste të fruthit, falë shkallës së lartë të vaksinimit kundër fruthit dhe rubeolës në 95 për qind. Kështu është thënë të martën në shënimin e fillimit të Javës së Imunizimit në Kosovë 2018.

Zëvendësministri i Shëndetësisë, Rrustem Musa, ka thënë se Programi i Zgjeruar i Imunizimit (PZI) është me prioritet të lartë. "Ministria e Shëndetësisë ka miratuar politikën e imunizimit, planet për sigurimin e vaksinave dhe materialin tjetër të hartuar dhe implementuar nga IKShP-ja. Për ta zvogëluar shkallën e lartë të sëmundjeve dhe vdekshmërisë, objektivi kryesor i PZI-së është

arritja e shkallës së lartë të përfshirjes me vaksinim të rregullt, sidomos të fëmijëve të grupmoshës 0-12 muaj", ka thënë Musa, duke shtuar se MSh-ja është duke realizuar me sukses edhe programe të veçanta të përfshirjes së fëmijëve të komunitetit serb, rom, ashkali dhe egjiptian, në mënyrë që asnjë fëmijë të mos mbetet pa vaksinim.

Drejtori ekzekutiv i IKShP-së, Naser Ramadani, ka thënë se falë PZI-së në Kosovë nuk ka sot paralizë të fëmijëve. "Nuk ka difeteri që nga viti 1981. Po ashtu, është përqafuar programi për eliminimin e fruthit dhe kontrollin e rubeolës kongjenitale", është shprehur Ramadani. Shefi i Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Brandao Co, ka thënë se imunizimi është një nga intervenimet më efektive të shëndetit publik dhe ka potencial për ta reduktuar vdekshmërinë e



fëmijëve. Ai ka shtuar se ky program do të mbështetet nga UNICEF-i me qëllim që të arrihen edhe grupet e cënueshme dhe të promovohet imunizimi si intervenim i lirë dhe efektiv. Ndërkaq shefja e Zyrës së OBSH-së në Kosovë, Ardita Tahirukaj, ka thënë se imunizimi është e drejtë dhe përgjegjësi e përbashkët. "Çdo person meriton të

mbrohet nga sëmundjet e parandalueshme me anë të vaksinave. OBSH-ja bashkohet me autoritetet e Kosovës duke u kërkuar të gjithëve që familja e tyre të jetë e vaksinuar dhe plotësisht e informuar rreth vaksinave dhe sëmundjeve të rrezikshme, në mënyrë që sëmundjet t'i parandalojmë", ka thënë Tahirukaj.

Një prezantim të detajuar rreth Programit të Zgjeruar të Imunizimit e ka bërë edhe shefja e Departamentit të Epidemiologjisë nga IKShP-ja, Isme Humolli, ku, ndër të tjera, janë theksuar edhe aktivitetet e ndërmarra ndër vite dhe hartimi i Planit Strategjik të Imunizimit, i cili pritet të miratohet së shpejti nga Ministria e Shëndetësisë.

Deputetët thonë se duhet të nisë mbikëqyrja parlamentare për FSK-në

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka diskutuar të martën lidhur me raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2018. Pasi kryetari i Komisionit, Haxhi Shala, dha disa të dhëna të dala nga raporti i KE-së, që prek kryesisht fushën e sigurisë në vend, u vë në pah faktin nga të gjithë anëtarët e Komisionit se, sipas këtij raporti, mbikëqyrja e FSK-së është jo e kënaqshme. Përkritazi me këtë u tha se ka pasur edhe kritika për komi-



sionin. Në këtë çështje u fokusua edhe ky diskutim. Pasi u përmend fakti se, bazuar në këtë raport të KE-së, ka pasur rënie të numrit të qytetarëve që shkojnë në luftë jashtë vendit, aty ishte

vlerësuar edhe Ligji për të huajt dhe azil. Ndërsa u tha se Policia e Kosovës mbetet institucioni më i besueshëm. Ky komision kryesisht ka diskutuar lidhur me krijimin e një grupi pune për

mbikëqyrje të Ligjit për FSK-në. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka thënë se është koha që komisioni ta fillojë mbikëqyrjen parlamentare

për FSK-në. Po ashtu, edhe deputeti i PDK-së, Fatmir Xhelili, ka thënë se duhet të fillojë mbikëqyrja parlamentare për FSK-në. Pas këtij diskutimi, komisioni ka shqyrtuar dhe përkrahur për miratim në seancë plenare raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017, duke rekomanduar njëherazi që Qeveria ta procedojë në Kuvend çështjen e emërimit të bordit të kësaj agjencie. Në këtë pikë pati kritika të shumta, meqë u sqarua se kjo agjenci funksionon pa bord që dy vjet.

Tryezat e partive politike vlerësohen blerje kohe

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) sot (e mërkurë) në ambientet e Kuvendit të Kosovës do ta organizojë tryezën me partitë e tjera politike, ku çështje diskutimi do të jetë gjendja e krijuar në vend. Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se një ndër tri temat që do të diskutohen në këtë tryezë do të jenë edhe zgjedhjet e parakohshme. Ndërkaq analistët politikë thonë se tryezat e thirrura nga partitë politike javë veçse blerje kohe sa për ta mbajtur afër elektoratin e tyre

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 PRILL - Tryeza e partive politike për tejkalim të krizës institucionale dhe politike, e cila është organizuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), do të mbahet sot (mërkurë) në orën 13:00 në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës.

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se një ndër tri temat që do të diskutohen në këtë tryezë do të jenë edhe zgjedhjet e parakohshme. Ai ka thënë se shumica e partive politike e kanë konfirmuar pjesëmarrjen në këtë tryezë. "LDK-ja vlerëson se vendi ka hyrë në krizë institucionale dhe politike, veçanërisht pas humbjes së shumicës në Kuvendin e Kosovës të koalicionit qeverisës. Si rezultat i kësaj gjendjeje, temat e rëndësishme nacionale nuk mund të adresohen prandaj, për të dalë nga kjo situatë, zgjedhjet e parakohshme janë të domosdoshme", ka thënë Hoti, duke shtuar se është në interesin më të mirë të qytetarëve që partitë politike të arrijnë konsensus

për temat e rëndësishme nacionale, parimet që duhen ndjekur në adresimin e këtyre temave, pavarësisht kush qeveris, si dhe përgatitjet e nevojshme për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme të lira dhe demokratike, për të nxjerrë një qeveri stabile të një shumicë.

Ndërkaq politologu Ramush Tahiri nuk beson në suksesin e iniciativave të subjekteve politike për arritjen e konsensusit kombëtar rreth çështjeve të mëdha. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se iniciativa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe ajo e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) janë të pasinqerta dhe do të dështojnë. Sipas tij, subjektet politike nuk do t'u përgjigjen pozitivisht këtyre iniciativave, duke i vënë kushte njëra-tjetrës.

Tahiri ka bërë me dije se iniciativat e tilla janë të shtyra nga pat pozicioni që gjenden pozita dhe opozita. Ai ka deklaruar se opozita nuk i ka 61 vota për ta rrëzuar Qeverinë, kurse kjo e fundit nuk e ka shumicën e nevojshme për t'i shtyrë proceset përpara. "Qëllimi i këtyre iniciativave



është për të blerë kohë dhe për të mos e humbur elektoratin. Pra, për ta mbajtur gjendjen e tensionuar në sensin pozitiv, duke thënë se kemi një agjendë dhe se jemi duke u munduar ta gjejmë një konsensus kombëtar për çështje të mëdha", ka thënë Tahiri.

Ai ka thënë se një iniciativë të tillë do duhej ta merrte presidenti i vendit. "Pas iniciativës për ta rrëzuar Qeverinë që nuk e çoi deri në fund, LDK-ja tash ka dalë me një propozim për ta realizuar një tryezë në të cilën do të diskutohet dhe do të arrihen parime për një konsensus kombëtar. Tash edhe Kadri Veseli në emër të PDK-së, gjithë liderëve të partive politike, u ka dërguar një propozim për një platformë gjithëkombëtare, në të cilën i ka numëruar çështjet kryesore për të cilat duhet të arrihet konsensus. Ky konsen-

sus po kërkohet në një tryezë të partive politike, të cilën zakonisht duhet ta bëjë presidenti i Kosovës dhe kjo nuk po bëhet në parlament", ka thënë politologu Ramush Tahiri.

Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh lider i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka propozuar një platformë politike për bashkimin e spektrit politik në Kosovë rreth pesë temave me interes nacional. Këtë platformë Veseli ua ka dërguar të gjithë liderëve të partive politike, nëpërmjet së cilës u bënë thirrje për krijimin e një ekipi të përbashkët të liderëve politikë me pjesëmarrje edhe të shoqërisë civile për këto pesë tema: 1. Dialogu me Serbinë, 2. Themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, 3. Themelimi i Ushtrisë së Kosovës, 4. Agjenda

e integriteteve evropiane, dhe 5. Reforma zgjedhore.

Veseli ka pohuar se kjo platformë ka për qëllim arritjen e konsensusit politik për disa prej çështjeve më të rëndësishme me të cilat Republika e Kosovës është përballur më herët dhe është duke u përballur aktualisht. "Çështjet të cilat do të përfshihen kjo platformë janë ndër më të rëndësishmet për perspektivën e Kosovës dhe qytetarëve të saj. Këto çështje që një kohë të gjatë janë duke e penguar ecjen përpara të Republikës së Kosovës. Me qëllim që të kemi një zgjidhje efikase, në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës, është i nevojshëm ndërtimi i konsensusit politik mes nesh. Ky konsensus, para së gjithash, duhet ta reflektojë interesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës", ka thënë Veseli.

Të rinjtë, të pakënaqur me qeverisjen në kryeqytet



Qeverisja në kryeqytet ka anashkaluar shumë aktivitete të ndryshme edukativo-arsimore dhe kulturore të këtyre të rinjve", është thënë në njoftimin e LDK-së. Sipas këtij njoftimi, Dumoshi u ka premtuar se të rinjtë janë prioritet i LDK-së dhe në cilësinë e anëtares së kryesisë së kësaj partie u ka ofruar këtyre të rinjve mbështetje në aktivitetet e tyre

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Një grup i të rinjve kanë vizituar të martën selinë e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe janë takuar me anëtares e kryesisë së kësaj partie, Vlora Dumoshin. Sipas një njoftimi të LDK-së, gjatë këtij takimi u diskutua për aktivitetet, prioritetet dhe sfidat e këtyre të rinjve. "Këta të rinj shprehën pakënaqësinë e tyre për keq-qeverisjen e kryeqytetit dhe

problemet dhe shqetësimet e tyre. Qeverisja në kryeqytet ka anashkaluar shumë aktivitete të ndryshme edukativo-arsimore dhe kulturore të këtyre të rinjve", është thënë në njoftimin e LDK-së. Sipas këtij njoftimi, Dumoshi u ka premtuar se të rinjtë janë prioritet i LDK-së dhe në cilësinë e anëtares së kryesisë së kësaj partie u ka ofruar këtyre të rinjve mbështetje në aktivitetet e tyre.

Eksporti i Kosovës në mars mbuloi importin 10.4 për qind

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin mars 2018.

Të dhënat nga Tregtia e Jashtme në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të ulët për 1.9 për qind në muajin mars 2018, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2017, gjegjësisht në vlerë prej 228.9 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 233.3 milionë eurosh në vitin 2017. Eksporti mbulon importin me 10.4 për qind.

Eksporti i mallrave në muajin mars 2018 kishte vlerën 26.4 milionë euro, ndërsa importi

255.4 milionë euro, që është një rënie prej -15.4 përqindësh për eksport dhe -3.5 për qind për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 26.1 për qind të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 15.3 për qind e përbëjnë produktet minerale; 13.3 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 13.3 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 4.9 për qind e përbëjnë produktet bimore; 4.7 për qind e përbëjnë lëkura dhe artikujt prej saj; 4.5 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike;

4.2 për qind e përbëjnë tekstili dhe artikujt prej tij; 4.0 për qind e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar etj. Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 12.8 për qind të importit e përbëjnë produktet minerale; 11.7 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11.2 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 10.8 për qind e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 9.8 për qind e përbëjnë produktet e industrisë kimike; 8.6 për qind e përbëjnë mjettet e transportit; 6.8 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 5.6 për qind e përbëjnë produktet bimore.



Studentët e infermierisë njoftohen për punësim në Gjermani



**EPOKA
ERE**

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 PRILL - Është mbajtur ceremonia e "Interpersonnel Kosova" dhe "Dekra" lidhur me njoftimin e punësimit të studentëve të infermierisë në Gjermani. Infermierët fillimisht do ta kryejnë trajnimin dhe mësimin e gjuhës gjermane, si dhe do të paguhet me pagë prej 1 500 eurosh. Po ashtu, ata do të

pajisen me viza dhe do të integrohen në jetën shoqërore.

Drejtori i "Interpersonnel Kosova", Musa Ahmeti, ka theksuar se ky punësim është mundësuar falë bashkëpunimit me kompaninë "Dekra". "Ne punojmë me infermierë dhe mësimin e gjuhës së tyre. Ata e kanë punën e garantuar. Ne nuk përgatisim kuadro vetëm sa për të dalë jashtë, por që ata të jenë të gatshëm për tregun e punës. Kushtet

për punësim janë: diploma, licenca e punës dhe dokumentacioni që nuk janë nën hetim", është shprehur Ahmeti.

Ndërsa ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ka thënë se Kosova është duke bërë një udhëtim për ta parë zhvillimin ekonomik. Ai ka thënë se synimi i tyre është për të pasur investim në arsim. "Çdo investim që bëjmë tek të rinjtë tanë është për

të qenë të gatshëm për tregun e punës. Kjo është gjëja më e mirë që mund ta bëjmë", ka thënë Bytyqi.

Ndërsa ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, ka thënë se në vazhdimësi janë duke u përpjekur që të rinjtë të jenë më afër tregut të punës. "Në kuadër të ministrisë sonë ekzistojnë tetë qendra të aftësisë profesionale që janë duke e bërë një punë për

tregun e punës", ka thënë Reçica. Ndërkaq zëvendësdiri i kompanisë "Dekra", Dietmar Metzger, ka thënë se në esencë ideja për këtë punësim është që t'u ofrojnë siguri studentëve të Kosovës. "Në esencë ideja fillestare është të ofrojë siguri dhe në këtë rast për studentët që janë pjesëmarrës në këtë institucion t'u sigurohet punë në Gjermani, ku paga do të jetë 1 500 euro neto", ka thënë Metzgeri.

75 për qind e ujërave në Kosovë keqmenaxhohen

Kryetari i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, Daut Haradinaj, ka shprehur shqetësim për sektorin e ujërave në Kosovë. Ai ka thënë se urgjentisht duhet të intervenohet në këtë sferë pasi, sipas tij, në Kosovë derdhën apo keqmenaxhohen 75 për qind të ujërave

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 24 PRILL - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, i drejtuar nga Daut Haradinaj, kryetar, ka mbajtur të martën mbledhjen e radhës, në të cilën është shqyrtuar strategjia shtetërore për ujëra në Kosovë 2017-2036, si dhe raporti për vitin 2017 nga Autoriteti Rregullator për ujëra. Përfaqësuesi i Këshillit Ndërmjësor për Ujëra, Baton Begolli, para komisionit ka prezantuar dy objektivat kryesore lidhur me ujërat në Kosovë. Ai ka thënë se Kosova në tërësi ka mungesë të ujërave në katër pellgjet kryesore: Drini i Bardhë, Moravë e Binçës, Ibër Lepenc dhe Ibër.

Akumulimet për kokë banori, sipas Begollit, janë vetëm 42 për qind të rajonit, kurse të reshurat vjetore për kokë banori janë 41 për qind. Begolli ka konsideruar se këto dy çështje e argumentojnë nevojën për mbrojtjen e resurseve aktuale dhe zhvillimin e resurseve të reja. Po ashtu, ka theksuar se ka humbje të madhe të ujit dhe vuri në dukje financimin e projektit të CDI-së Zvicerano-Kosovar për sistemet

rurale të ujit dhe kanalizimeve, e cila, sipas tij, ka bërë regjistrimin e gjendjes faktike në tërë territorin e Kosovës. Begolli ka shtuar se, bazuar në të dhënat e këtij projekti, diku 84.32 për qind të popullatës kanë mbulueshmëri në rrjetet publike. Ai ka thënë se strategjia shtetërore për ujëra në Kosovë 2017-2036 ka nevojë për përmirësim pasi është hartuar në vitin 2014.

Kryetari i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, Daut Haradinaj, ka shprehur shqetësim për sektorin e ujërave në Kosovë. Ai ka thënë se urgjentisht duhet të intervenohet në këtë sferë pasi, sipas tij, në Kosovë derdhën apo keqmenaxhohen 75 për qind e ujërave. Ai ka përmendur një varg dështimesh të projekteve të ujësjellësit, për të cilat ka thënë se Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor nuk është treguar serioze në këtë drejtim. "Fatkeqësisht, në Kosovë mbi 75 për qind e ujërave në Kosovë keqmenaxhohen. Po ashtu, ka burokraci në mes të komunikimit zinxhiror si dhe politizim të bordit", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se nuk është në



rregull kur temperaturat janë të larta t'i lënë banorët pa ujë. Ai ka shtuar se ka mbetur në gjysmë projekti në Istog - Klinë, Rahovec, Gjakovë, Deçan dhe në shumë komuna të tjera. Vërejtje për sektorin e ujërave ka dhënë edhe anëtarja e këtij komisioni, deputetja Ganimete Musliu, e cila ka theksuar se është shqetësuese derdhja e ujërave të zeza në Liqenin e Batllavës. "Në Liqenin e Batllavës derdhën ujërat e zeza si dhe ndërtohen stalla për-reth", ka thënë Musliu. Gjithashtu, vërejtje për këtë sektor ka dhënë edhe deputeti i GDP-së, Salih Salihu. Ai ka thënë se është e nevojshme që në Kosovë të ndërtohet një akumulues i ujërave dhe të lihet anash një autostradë. "Ministria e Planifikimit Hapësinor nuk është duke e shqyrtuar si duhet resursin ujqor.

Neve uji na humbet pasi nuk kemi akumulim të ujit. Nuk mund të kemi bujqësi të zhvilluar pa ujë. Kosova ka nevojë të domosdoshme të ketë akumulim të ujit pasi do të ndikonte edhe në zhvillimin ekonomik", ka thënë Salihu. Begolli u përgjigj në pyetjet e ngritura nga anëtarët e komisionit duke dhënë sqarimet përkatëse që janë në fushëveprimarinë e këtij institucioni. Pas deklarimeve të deputetëve, komisioni e ka miratuar me shumicë votash strategjinë shtetërore për ujëra në Kosovë për vitin 2017-2036. Në pjesën e dytë të mbledhjes së këtij komisioni ka raportuar drejtori i Autoritetit Rregullativ për Ujëra (ARRU), Raif Preteni, i cili ka pohuar se ARRU edhe gjatë vitit 2017 ka vazhduar t'i zbatojë praktikatat më të mira

rregullatore për ta siguruar ngritjen e nivelit të shërbimeve të ujit. Preteni ka bërë me dije se ndër angazhimet kryesore të ARRU-së gjatë këtij viti ka qenë përcaktimi i tarifave për periudhën e ardhshme trevjeçare dhe procesi tarifor 2018-2020. Lidhur me këtë, ai ka thënë se tarifat për periudhën 2018-2020 janë përcaktuar nga të dhënat e Biznes-Planeve Rregullatore, të cilat janë aprovuar nga ARRU-ja. Preteni ka vlerësuar se ARRU-ja është munduar të mbajë ekuilibër për të siguruar që konsumatorët të marrin shërbime të cilësisë më të mirë të mundshme dhe me një çmim të arsyeshëm. Pas diskutimeve dhe pyetjeve të deputetëve, raporti për vitin 2017 nga Autoriteti Rregullator për ujëra u përkrash njëzëri nga komisioni.

Ministri Lluka në Uashington merr mbështetje për projektet në fushën e energjisë

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, së bashku me ministrin e Financave, Bedri Hamza, po qëndrojnë në Uashington. Ata po marrin pjesë në takimet pranverore të Bankës Botërore dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare për çështje ekonomike, me fokus të veçantë të energjisë. Ministri Lluka dhe Hamza zhvilluan takim me Cyril Muller, zëvendës-president i Bankës Botërore për Evropë dhe Azinë Qendrore, si dhe Laura Tuck, zëvendës-presidente e Bankës Botërore për Zhvillim të Oëndrueshëm, ku u njoftuan me dinamikën e punëve dhe progresin në



fushën e energjisë, me theks aprovimin e Strategjisë së

Energjisë 2017-2028. Gjatë këtij takimi ministri

Lluka ka theksuar rëndësinë e strategjisë për avancimin e

bazës ligjore si dhe krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm në fushën e energjisë. Zëvendës-presidenti i Bankës Botërore për Evropë dhe Azinë Qendrore, Cyril Muller, ka përgëzuar ministrin Lluka për aprovimin e strategjisë dhe ka rikonfirmuar mbështetjen e tij për implementimin e projekteve që dalin nga kjo strategji, me theks në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese siç është termocentrali "Kosova e Re", zhvillimi i projekteve nga fusha e burimeve të ripërtitshme si dhe mbështetja shtesë për investime në masa të eficientës.

Fillon së shpejti realizimi edhe i një projekti në hapësirat përreth lumit Ibër

MITROVICË, 24 PRILL (ER) - Komuna e Mitrovicës së shpejti do ta fillojë realizimin edhe të një projekti kapital, në vlerë prej katër milionë eurosh.

Fjala është për projektin "Rregullimi i shtratit të lumit Ibër", i cili do t'ia shtojë hijeshinë qytetit të Mitrovicës, duke e bërë kështu edhe më atraktiv për vizitorët nga i tërë vendi, ashtu sikur që po e vizitojnë liqenin artificial.

Kryetari i komunës, Agim Bahtiri, bashkë me përfaqësuesit e kompanisë "Infratek", e kontraktuar nga komuna për hartimin e projekteve të

ndryshme, ka dalë në vendin ku parashihet të realizohet projekti, për t'i dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e tij për projektin ideor para se ai të shndërrohet në projekt konkret për realizim. Gjatë diskutimit me ekspertët e kompanisë "Infratek", për hartimin e projektit për rregullimin e shtratit të lumit Ibër dhe hapësirës përreth lumit, Bahtiri ka kërkuar nga projektuesit që të gjitha elementet e dhëna nga komuna të respektohen maksimalisht dhe që projekti të kryhet brenda pak ditësh, në mënyrë që të fillojë menjëherë puna për realizimin e tij.




Prishtina me projekt për ngritjen e nivelit të sigurisë rreth parkut të qytetit

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me UN Habitatin dhe UN Women, është duke e realizuar projektin për auditimin e sigurisë dhe punëtorinë Bllok pas Blloku - Minecraft për intervenimet e nevojshme në lagjen rreth parkut të qytetit. "Ky është një proces përmes të cilit pjesëmarrësit analizojnë karakteristikat fizike të një hapësirë publike, shprehin mendimet e tyre se si hapësirat në fjalë mund të reflektojnë pasiguri dhe ofrojnë

propozime konkrete për përmirësimin e mjedisit urban", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.

Me këtë rast, do të intervenohet në ndriçim, shenjëzim, infrastrukturë rrugore, organizim të hapësirës, mirëmbajtje dhe funksione të tjera urbane. Auditimi i sigurisë bëhet përmes ecjeve në grup, në kohë të ndryshme gjatë ditës dhe natës. Thelbi i këtij aktiviteti është krijimi i një mjedisi të sigurt, sidomos për gratë dhe vajzat.



Një kompani nga Kanadaja interesohet për zinkun e Kosovës

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës dhe ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka pritur një delegacion të kompanisë "Trevali", e cila është fokusuar në sektorin e minierave, në veçanti atë të zinkut. Në prezantimin e kësaj kompanie Mark Cruise, që është president dhe CEO i kom-

panisë, ka treguar për operacionet të cilat momentalisht i kanë në Kanada dhe Afrikë, ndërsa tash janë të interesuar në sektorin e minierave të Kosovës.

Gashi e ka informuar delegacionin nga Kanadaja për ndryshimet të cilat do t'i bëhen Ligjit për investime strategjike në sektorin e minierave. "Ne

jemi duke e përmirësuar legjislacionin. Tani në sektorin e minierave do të kemi atë që quhet 'one stop shop', ndërsa për kompanitë të cilat kualifikohen si investitore strategjike me ndryshimet e ligjit do t'i heqim edhe disa barrierat shtesë për ta bërë procesin më të lehtë dhe më të favorshëm", ka deklaruar Gashi.



Përkujtohet ish-kryetari i Klinës, Ismet Rraci

KLINË, 24 PRILL (ER) - Të martën është përkujtuar ish-kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Klinë, njëherësh ish-kryetari i kësaj komune, Ismet Rraci. Nën

organizimin e kryetarit të Degës së LDK-së në Klinë, Fadil Gashi, homazhe te varri i tij në Siqevë dhe para bustit të tij, në emër të kryesisë së LDK-së, ka bërë Gazmend Muhaxheri,

deputetja e Kuvendit të Kosovës, Mirjeta Kalludra dhe drejtori i Administratës së LDK-së, Selver Doda, bashkë me këta edhe familjarë dhe qytetarë të Klinës.

Kthehet mbrapsht Projektligji për Prishtinën

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) -

Komisioni për Legjislacion ia ka kthyer Projektligjin për Prishtinën, bashkë me amendamentet e propozuara, Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie, me arsyetimin se shumica e amendamenteve janë kundër Kushtetutës. Neni më problematik i propozuar në Projektligjin për Prishtinën ishte neni 2, në të cilin shkruhet për kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën dhe Prizrenin. Po ashtu, çështje problematike ishte edhe amendamenti që parashihet themelimin e Drejtorisë së Policisë së Kryeqytetit, drejtorin e

të cilit e emëron drejtpërdrejt kryetari i komunës. Projektligji për Prishtinën ka kohë që silltet nëpër sirtarët e Qeverisë, derisa menjëherë pas ardhjes së Ramush Haradinajt në krye të ekzekutivit ky ligj është proceduar për në Kuvendin e Kosovës. Edhe me Kushtetutë parashihet që Prishtina të rregullohet me ligj të veçantë.



'Ibrahim Rugova' nuk është në gjendje të mirë

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Autostrada "Ibrahim Rugova", e cila buxhetit të Kosovës i ka kushtuar rreth një miliard euro, edhe

pse e punuar me standarde evropiane dhe e ndërtuar nga një kompani me renome ndërkombëtare siç është "Bechtel-Enka",

ajo gjatë stinës së vjeshtës dhe të dimrit e humbet bukurinë e një autostrade, ndërtimi i së cilës ka kushtuar shtrenjtë.

Nis ndërtimi i rrugës Deçan - Plavë

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka bërë me dije se projekti i rrugës Deçan-Plavë do të përfundojë në vitin 2020 si dhe kostoja e tij do të jetë 12 milionë euro. Lekaj ka theksuar se kjo rrugë do të ketë ndikim pozitiv shumëdimensional

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

DEÇAN, 24 PRILL - Të martën kanë nisur punimet për ndërtimin e rrugës Deçan-Plavë, e cila lidhë rajonin e Dukagjinit me atë të Plavës dhe Gucisë. Me këtë rast, ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka thënë se kjo rrugë do të ketë ndikim pozitiv shumëdimensional. Sipas tij, nuk ka ndjenjë më të mirë sesa të jesh në shërbim të qytetarëve, të lëvizjes së lirë, të investimeve dhe zhvillimit të turizmit. "Për mua është ditë e veçantë sepse na është dhënë rasti të fillojmë

një rrugë që lidhë Deçanin dhe Kosovën me Malin e Zi, sidomos me atë pjesë ku banojnë shqiptarët. Nuk ka ndjenjë më të mirë se kur jemi në shërbim të qytetarëve, të lëvizjes së lirë, të investimeve dhe zhvillimit të turizmit. Kjo rrugë ka ndikim pozitiv shumëdimensional", ka thënë Lekaj. Ai ka shtuar se këto bleshkë janë atraktive për zhvillimin e turizmit, sidomos edhe për transport të mallrave si lidhje me Malin e Zi. "Jam i vendosur që ky projekt të zhvillohet deri në fund", është shprehur Lekaj.

Ministri Lekaj ka bërë me dije se projekti i rrugës Deçan -



Plavë do të përfundojë në vitin 2020 si dhe kostoja e tij do të jetë 12 milionë euro. "Për këtë

vit janë ndarë katër milionë euro, kurse për vitin 2019 do të ndahen edhe 8 milionë euro të

tjera, kurse projekti në tërësi do të përfundojë në vitin 2020", ka deklaruar Lekaj.

Bahtiri nënshkroi vazhdimin e kontratave për bursa për 78 studentë

MITROVICË, 24 PRILL (ER) - 78 studentëve nga Komuna e Mitrovicës u është vazhduar kontrata për bursa për vitin akademik 2017/2018. Me këtë rast, kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka thënë se të rinjtë duhet të fokusohen në studime, meqë është mënyra më e mirë që hap rrugë për punësim. "Duke pasur parasysh rezultatet e mira në

mësime, ju inkurajoj të punoni dhe të studioni sa më shumë për një të ardhme më të mirë për vete dhe për shoqërinë", ka thënë Bahtiri. Ai ka shtuar se është shumë e rëndësishme që studentëve t'u ndihmohet gjatë studimeve të tyre, prandaj komuna edhe në të ardhmen do të vazhdojë t'i ndihmojë studentët si me

përkrahje financiare, po ashtu edhe në forma të tjera. Komuna e Mitrovicës do ta paguajë bursën për studentët për vitin akademik 2017/2018 duke filluar nga 01. 10. 2017 deri 30. 6. 2018, në shumën prej shtatëdhjetë eurosh. Pas nënshkrimit të kontratës, studentët janë shprehur të jenë të kënaqur me ndarjen e këtyre bursave.



Vdes aktori Art Kurti, policia dyshon se është vetëvrarë

GJAKOVË, 24 PRILL (ER) - Art Kurti aktori gjakovar i cili ishte i angazhuar në serialin "O sa mirë", së fundi edhe këshilltar në kabinetin e kryetarit të Komunës së Gjakovës, dyshohet se u vetëvra të martën.

Policia e Kosovës ka bërë me dije se po heton rrethanat në rastin e aktorit nga Gjakova, i cili u gjet i vdekur me një plumb në kokë në një veturë në fshatin Goden, në periferi të qytetit. "Dyshimet e para çojnë në dyshime për vetëvrasje. Në veturë është gjetur vetëm një armë dhe viktima ka

pasur një fishek të shkrepur në kokë", ka thënë Kristë Gjoka, komandant i policisë në Gjakovë. Drejtuesit e serialit "O sa mirë" përmes faqes zyrtare në llogarinë në "Facebook" kanë pohuar se vdekja e Artit ishte dhimbje e tmerrshme për ta. "Dhimbje të tmerrshme dhe pikëllim të pakufishëm na dha sot lajmi për vdekjen e Art Kurtit, kolegut fantastik që kishim në serialin 'O sa mirë'. Tepër i ri për të shkruar. Do ta kujtojmë gjithmonë mirësinë e tij, talentin e tij, të qeshurën e tij. Ngushëllime familjarëve, artistëve dhe miqve!", thuhet në postimin e tyre.

Edhe kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka thënë se është i shokuar nga lajmi për vdekjen e aktorit të serialit "O sa mirë", Art Kurti. "Jam i shokuar nga lajmi që kolegu ynë Art Kurti nuk është më me ne. Kolegët e mi dhe unë ndiejmë dhimbje të thellë për këtë humbje. Largimi kaq i hershëm dhe i

papritur i Artit, nga familja dhe të gjithë ne, do të jetë vështirë i përballueshëm. U shpreh ngushëllimet e mia më të sinqerta familjes, kolegëve dhe miqve", ka thënë Gjini. Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i ka shprehur ngushëllime familjes Kurti dhe komunitetit të artistëve me rastin e vdekjes së aktorit Art Kurti. "Si një mysafir i 'O sa mirë' kam kaluar momente të jashtëzakonshme me të gjithë aktorët, me stafin e serialit, përfshirë Art Kurtin, i cili sot paska ndërruar jetë. Një lajm ky tejet pikëllues. Ngushëllime familjarëve, kolegëve nga komuniteti i artistëve dhe gjithë miqve të tij", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Telegram ngushëllimi familjes Kurti i ka dërguar edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi. "Lajmin për vdekjen e parakohshme të të dashurit tuaj, Artit, aktorit tonë të mirënjohur, e morëm me pikëllim të madh. Bota e artit ka humbur një prej aktorëve të rinj më të talentuar. Ngushëllime familjes, miqve dhe dashamirëve të Art Kurtit!", është thënë në telegramin ngushëllues të ministrit Gashi.

Gashi: Manifestimi për shënimin e 140-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit do të jetë madhështor

PRISHTINË, 24 PRILL (ER) - Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", të martën është mbajtur takimi i Komisionit Qeveritar për shënimin e 140-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit. Në këtë mbledhje morën pjesë përfaqësues të institucioneve të kulturës të Republikës së Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se nga institucionet relevante

të Republikës së Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë po punohet jashtëzakonisht shumë në mënyrë që organizimi për shënimin e 140-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit të jetë sa më madhështor dhe të shënohet në mënyrën sa më të mirë të mundshme.

Pjesëmarrësit e këtij takimi diskutuan gjatë rreth agjendës për ditën e 10 qershorit për shënimin e 140-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit.



Botohet edhe një libër për Lëvizjen Studentore të vitit 1997

PRISHTINË, 24 PRILL - Gazetari i Radio Televizionit të Kosovës, Afet Bela, i cili është duke i vijuar studimet për doktoratë, ka botuar një libër, konkretisht punimin e diplomës të masterit, që kishte temë Lëvizjen Studentore të vitit 1997, protestën e saj të organizuar më 1 tetor të '97-s në Prishtinë. Ky libër i Belës, me titull "Lëvizja e lirisë" dhe nëntitull "Lëvizja Studentore e vitit 1997 nën vëzhgimin e mediave", ka pesë kapituj, në të cilët autori ka ndjekur hap pas hapi, idenë e realizimit të protestës së organizuar nga Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të

Prishtinës në vitin 1997, pastaj raportimet e mediave vendore dhe ndërkombëtare për jehonën e asaj ngjarjeje, por edhe të disa të tjerave që ndodhën pas asaj proteste në Prishtinë.

Librit i prinë parathënie shkruar nga autori, më pas vijonë kapitujt Protesta si alternativë, Shtypi i kohës për protestën e 1997-s, Efekti i kësaj ngjarjeje në Kosovë dhe jashtë saj, Jehona e protestës në media, Protesta dhe qëndrimi i partive politike për protestën, Gazetat në Kosovë në vitin 1997 dhe raportimi i tyre për protestën, Thyerja e status quos, Shtypi i



Shqipërisë dhe raportimet për Shtypi i Serbisë për ngjarjet e ngjarjet e '97-s në Kosovë, '97-s në Kosovë, Raportimet e

mediave ndërkombëtare për protestën e vitit 1997 në Kosovë. Libri ka edhe një album të fotografive nga realizimi i protestës nga Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Prishtinës, në të cilin shihen se si, ndër të tjera, policët serbë rrahin, tërheqin zvarrë, gjuajnë me gurë dhe mjete të forta, sjellin me grushte, shqelma dhe me shkopinj prej gome dhe të metaltë, në studentët shqiptarë, të cilët atëkohë kërkonin lirinë e objekteve mësimore që kishin uzurpuar masat e dhunshme serbe. Ky libër është botuar nga shtëpia botuese "Armagedoni".

E rrallë

Shefi çon 500 veta të stafit për pushime në Hauai

Aktori i famshëm Ben Affleck njihet për zemërgjerësinë e thjeshtësinë e tij. Duket se pas përfundimit të xhirimeve të filmit të tij më të ri "Triple Frontier", 45-vjeçari vendosi ta çojë të gjithë skuadrën me pushime. Me një staf prej 500 vetash ai dhe e dashura e tij u nisën për në Hauai ku çdo gjë është e paguar dhe ka festë në çdo orë.



FOTO E DITES



Priftërinjtë e rinj shtrihen me fytyrë poshtë në dysheme në një ceremoni në Shën Bazilikën e Pjetrit në Vatikan. /AP/

E jashtëzakonshme

Dalin në ankand syzet e 9 presidentëve amerikanë

Një set i shkëlqyer me nëntë palë syze optike, të cilat iu përkisnin presidentëve të ShBA-së, do të dalë në ankand më 26 prill të këtij viti. Syzet e çmuara u përkisnin më parë presidentëve Harry S. Truman, Richard Nixon, Lyndon Johnson, Jimmy Carter, Gerald Ford, Ronald Reagan, Bill



Clinton dhe dy presidentëve Bush, të gjitha të dhuruara tek doktor Spencer E. Sherman, përgjegjës i Muzeut të Oftalmologjisë së San Franciscos.



DASHI

Sot kuadri yjor pritet mjaft i favorshëm për ju, prandaj edhe dita pritet të jetë përgjithësisht e mirë, ndërsa edhe gjendja juaj shpirtërore është në përmirësim të plotë.



DEMI

Shenja juaj sot pritet të jetë disi e turbullt dhe kjo nuk ju favorizon aspak, prandaj është më mirë të mos ndërmerrni iniciativa me shumë rrezik për aktivitetet tuaja. Edhe në dashuri nuk jeni aq të favorizuar.



BINJAKËT

Edhe për ju që i përkisni kësaj shenje parashikohet një ditë nën shenjën e yjeve të mirë që do të thotë se do të keni një periudhë mjaft pozitive.



GAFORRJA

Pas një periudhe të shkurtër me depresion tani do të gjallëroheni ndjeshëm. Nuk duhet t'i merrni gjërat afër vetes, lëreni ato të ecin vetvetiu.



LUANI

Edhe pse sot nuk ndiheni mirë nga gjendja shëndetësore do t'ju duhet t'i mbyllni disa gjëra të rëndësishme që i kishit lënë për çast të fundit.



VIRGJËRËSHA

Do të keni debate të ashpra me një ortak në biznes ose me eprorin tuaj. Muaji që po vjen nuk do t'ju gjejë mirë nga ana financiare.



PESHORJA

Tensioni në ditët e fundit ju ka kapur edhe juve. Çdo gjë bëhet me vrap dhe në rrëmujë e sipër. Mund të harroni një mik pa e telefonuar.



AKREPI

Punët, humori dhe dashuria sot janë në ekuilibër të plotë. Do ta shijoni në çdo çast një ditë të mbushur me gëzim.



SHIGJETARI

Nuk duhet që me të mëdhenjve në moshë t'ju vini re çdo gjë që thonë sot. Sa më tolerant të jeni aq më shumë do ta shijoni ditën.



BRICJAPI

Dita e sotme karakterizohet nga tone të larta humori dhe ju do të jeni në mes të një ambienti që e njihni mirë. Miqtë kanë përgatitur një surprizë për ju.



UJORI

Po mendoni që situata në të cilën ndodheni mund të ishte më e mirë, por ju kënaqeni edhe me pak, kështu që do ta shijoni çdo moment të ditës.



PESHQIT

Edhe pse gjatë ditës do të keni mjaft agjendë të ngarkuar, do ta gjeni kohën dhe mundësinë për t'iu përkushtuar fëmijëve dhe më të rinjve.

BARSOLETA E DITËS



Burri: Grua, të kam tradhtuar një herë.
Gruaja: Edhe unë një herë.
Burri: 1 prilli a?
Gruaja: Jo më 1 prill, por më 1 maj.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

“BLACK PANTHER” 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

“PETER RABBIT”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck

Në ora 19:00

“PACIFIC RIM UPRISING” (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

“RED SPARROW” (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Shoenearts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Envert

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BAYERN MUNICH - REAL MADRID

1

BRACKLEY TOWN - CHORLEY

1

CAEN - TOULOUSE

2

Rexha preferon titullin para 'Këpucës së Artë'



Kastriot Rexha po pëlqen ta fitojë titullin e kampionit me skuadrën e Dritës para "Këpucës së Artë", ani pse me tregolëshin shënuar Llapit i ka rritur shanset për të qenë më i miri në Superligë. "Çdo sulmues e dëshiron këtë epitet, pasi ka vlera, mirëpo në këto çaste për mua i vetmi synim është titulli i kampionit me Dritën dhe jo çmimet individuale. Kam qenë shumë herë afër, por asnjëherë i pari. Prapë më shumë pëlqej titullin dhe suksesin me skuadrën sesa çmimin individual", ka thënë Rexha

EPOKA E RE**Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 24 PRILL - Sulmuesi Kastriot Rexha që nga koha kur ishte pjesë e skuadrës së 2 Korrikut nga Prishtina, më pas edhe me Trepçën '89 dhe Besën ka qenë në krye të listës së golashënuesve në Superligë, por asnjëherë nuk ka dalë të jetë i pari. Ai të martën për "Epokën e re" ka thënë se, pavarësisht prej faktit se nuk e ka fituar asnjëherë këtë çmim, më shumë pëlqen titullin e kampionit me Dritën se "Këpucën e Artë".

Para sulmuesit shtatllartë renditen Mirlind Daku i Llapit dhe Otto John i Trepçës '89 me nga 13 gola të shënuara, kurse Rexha ka shënuar një gol më pak. "Çdo sulmues e dëshiron këtë epitet, pasi ka vlera, mirëpo në këto çaste për mua i vetmi synim është titulli i kampionit me Dritën dhe jo çmimet individuale. Kam qenë shumë herë afër, por asnjëherë i pari. Prapë pëlqej më shumë titullin dhe suksesin me skuadrën sesa çmimin individual", ka thënë Rexha, duke folur edhe për tre golat që shënoi në ndeshjen kundër Llapit në Besianë.

"Kundër Llapit ka qenë një ndeshje shumë e rëndësishme për ne duke marrë parasysh se kemi qenë mysafirë të skuadrës se Llapit, e cila është një skuadër e papërshtatshme dhe e vështirë për t'u mposhtur në Besianë. Kemi bërë një paraqitje të mirë si skuadër dhe jemi në një moment mjaft të mirë dhe në rrugën e duhur drejt titullit të kampionit. Jam i kënaqur që skuadra ka shënuar fitore dhe që gjithë ata tifozë në numër të madh që ishin në Besianë janë kthyer të lumtur në Gjilan, por edhe tregolëshi më bën krenar", ka deklaruar Rexha, i cili ka

LISTA E GOLASHËNUESVE

	GOLA
1. Mirlind Daku (Llapi)	13
2. Otto John (Trepça '89)	13
3. Kastriot Rexha (Drita)	12
4. Genc Hamiti (Drenica)	11
5. Artur Magani (Liria)	11
6. Xhevdet Shabani (Drita)	10
7. Mark Milicaj (Feronikeli)	8
8. Betim Haxhimusa (Gjilani)	8
9. Albntrit Morina (Feronikeli)	7
10. Gauthier Mankenda (Prishtina)	7

pasur një karrierë të suksesshme edhe në futbollin e Shqipërisë, përkatësisht me skuadrën e Vllaznisë së Shkodrës. Lidhur me thashethemet se ndeshja Llapi - Drita (1-3) ishte e kurditur, Rexha nuk deshi të flasë shumë. Ai ka thënë se gjithkush që merr vesh në lojën e futbollit e ka parë se në këtë ndeshje nuk ka pasur asnjë shenjë se ka qenë e kurditur.

Bayerni, për hakmarrje kundër Realit

MUNICHEN, 24 PRILL (ER) - Trajneri i Bayern Munchenit, Jupp Heynckes, është i vendosur të arrijë fitore ndaj Real Madridit sonte (e mërkurë) në kuadër të gjysmëfinaleve të parë në Ligën e Kampionëve. Bayerni në dy edicionet e kaluar është eliminuar nga Realit dhe tash synon hakmarrjen ndaj kampionëve aktualë të Evropës. Trajneri veteran ka thënë se është shumë e rëndësishme të arrihet fitorja në ndeshjen e parë. "Unë i kam të gjithë lojtarët në dispozicion para këtij takimi me Realin dhe jemi të fokusuar në kjo përballje që do të luajmë para fansave tanë. E rëndësishme është të fitosh gjithnjë para një ndeshje në Ligën e Kampionëve. Do të jetë një ndeshje e hapur. Për mua nuk ka favorit. Personalisht kam një ndjenjë të mirë. Është një gjysmëfinale mes dy skuadrave,

që kanë një traditë të gjatë në Ligën e Kampionëve. Nuk ka favoritë. Ju mund të thoni se Real Madridi është dy herë radhazi fitues i Ligës së Kampionëve dhe ndoshta ka një avantazh, por edhe ne jemi shumë mirë. Ne po luajmë një sezon të jashtëzakonshëm, por duam ta kurorëzojmë me arritjen në finalen e Ligës së Kampionëve", ka thënë Heynckes.

Ndërsa mbrojtësi i Bayernit, Jerome Boateng, pati lëvdata për Cristiano Ronaldon, për të cilin mendon se është vështirë të neutralizohet krejtësisht. "Ju nuk mund ta neutralizoni krejtësisht, sepse gjithmonë arrin të krijojë shanse në një ndeshje, sepse ai ka një ndjenjë të shkëlqyeshme të largimit. Pra, është e rëndësishme të jemi kompaktë si ekip, për t'i lejuar sa më pak hapësirë që është e mundur një goleadori

**FORMACIONET E MUNDSHME**

Bayern Munchen: Ulrich; Kimmich, Bernat, Boateng, Hummels; Martinez, James, Thiago, Robben, Muller; Lewandowski.
Real Madrid: Navas; Carvajal, Ramos, Varane, Marcelo; Casemiro, Kroos, Modriq, Isco; Benzema, Ronaldo.

si ai. Kemi përvoja pozitive dhe negative me të. Me kombëtaren, pothuajse gjithmonë kemi arrit-

ur ta neutralizojmë, si në fitoren 4-0, në Kupën e Botës 2014. Me Bayern Munichun nuk na ka

ecur aq mirë. Sidoqoftë, Real Madridi nuk është vetëm Ronaldo. Edhe lojtarët e tjerë janë shumë të mirë", ka deklaruar Boateng.

Ndërsa mesfushori i Real Madridit, Toni Kroos, e pranon se "mbretërit" do ta kenë më problem ndaj Bayernit sivjet sesa që e kishin në vitin e kaluar. "Mendoj se do ta kemi më të vështirë se sezonin e shkuar. Kemi fituar dy herë radhazi Ligën e Kampionëve, një sukses që vështirë se do ta përsëritë ndonjë skuadër tjetër. E dimë dhe se mund të fitojmë ndaj kujtdo, sepse në Champions transformohemi", ka thënë Kroos.

Mungesat te Bayerni, përveç Manuel Neuerit, Arturo Vidal, Kingsley Coman, pritet të jetë edhe ajo e David Alabas, kurse te Realit pritet të mungojë mbrojtësi Nacho.

FFK: Kjo është risia në kualifikimet për Ligën e Kampionëve

PRISHTINË, 24 PRILL - Federata e Futbollit të Kosovës (FFK) nëpërmjet një njoftimi për medie ka bërë me dije se gjatë seminarit që UEFA e organizoi këto ditë, për Ligën e Kombeve, në të cilin ishte

pjesëmarrës drejtori i ekipeve kombëtare dhe për marrëdhënie me jashtë, Artan Govori, bashkë me menaxherin Rinor Havollin, u njoftuan edhe për ndryshimet në lidhje me kualifikimet e skuadrave

kampione në Ligën e Kampionëve. "Në fazën e parë do të ketë gara parakualifikuese ndërmjet kampionëve kombëtarë të ndara në grupe. Skuadra kampione e këtij edicioni në Vala Superligën e

Kosovës do të bëjë gara në Gjibraltar, ku në grup do të jenë veç kampionit nga mikpritësi, edhe kampioni i Andorrës, San Marinos dhe kampioni i Kosovës", thuhet në njoftimin e FFK-së. Ndeshjet

do të zhvillohen në fund të muajit qershor në Gjibraltar dhe shorti do të hidhet para fillimit të garave. Fituesi nga ky grup do t'i vazhdojë kualifikimet e rregullta në bazë të fituesve të grupeve të tjera.

Ejupi: Titulli varet nga Prishtina

PRISHTINË, 24 PRILL - FC Prishtina të martën ka vazhduar seancën stërvitore pas pushimit njëditor. Në seancën e zhvilluar në fushën e 2 Korrikut, futbollistët i vizitoi

kryetari i klubit, Remzi Ejupi. "Pas ndodhjeve të fundit në futbollin e Kosovës, sidomos ndëshkimit me tetë kartonë të verdhë në ndeshje të qetë si ishte ajo me Vllazninë, kërkoj

qetësi dhe mobilizim të trajnerëve dhe futbollistëve që ta arrijmë realizimin e synimeve të klubit. Janë edhe pesë ndeshje të mbetura dhe fati i titullit të kampionit varet

kryekëput nga rezultatet tona. Unë shpresoj dhe besoj, se rezultatet tona do të arrihen nga angazhimi maksimal i ekipit dhe klubit si dhe qetësia brenda ekipit", ka thënë Ejupi.



Vokri ofron mbështetje për klubet e komunitetit serb



PRISHTINË, 24 PRILL - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Fadil Vokri, priti kryetarin e Komunës së Parteshit, Dragan Petkoviç. Vokri e njoftoi Petkoviçin për zhvillimin e futbollit në Kosovë, në veçanti për angazhimin e tij dhe të FFK-së për përfshirjen e komuniteteve, veçmas atij serb, në futbollin e Kosovës. Deri me tani, veç disa klubeve serbe, në futbollin e Kosovës kemi shumë futbollistë dhe një gjyqtar të komunitetit serb. "Besoj shumë se tashmë

është krijuar një klimë e mirëbesimit dhe kushte jashtëzakonisht të mira që të ketë sa më shumë klube të komunitetit serb dhe ne si federatë do t'ju ofrojmë mbështetje", ka thënë Vokri, duke kërkuar nga Petkoviç që jo vetëm ai, por edhe zyrtarë të tjerë të angazhohen për inkuadrimin e klubeve serbe në futbollin e Kosovës si opsioni më i mirë për të ardhmen e tyre. Ndërsa kryetari i Komunës së Parteshit, Dragan Petkoviç, duke falënderuar presidentin Vokri

për këtë pritje, ka thënë se është fat i mirë që në krye të futbollit të Kosovës është një figurë kaq e njohur për futbollin jo vetëm të Kosovës, por edhe më gjerë. "Kjo na jep shpresë të besojmë se komuniteti dhe të rinjtë serbë mund të kenë besim për një trajtim të njëjtë me të tjerët. Do të punojmë dhe do të angazhohemi ne si komunë e re që ta themelojmë një klub ku do ta kishin aktivitetin e tyre talentet e rinj të futbollit nga komuniteti ynë", ka deklaruar Petkoviç.

Prishtina - Ylli, hap serinë e 'play-off'-it

PRISHTINË, 24 PRILL - Sonte (e mërkurë) me ballafaqimin në mes të Sigal Prishtinës dhe Golden Eagle Yllit do të nisë faza e "play-off"-it në IP Superligën e Kosovës në basketboll. Kjo ndeshje do të zhvillohet me fillim nga ora 19:30 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Ndërkaq të enjten do të luhet gjysmëfinalja tjetër ajo në mes të Bashkimit dhe Rahovecit me fillim nga ora 19:30 në Palestrën e Sportit "Sezai Surroi" në Prizren. Gjysmëfinalët e "play-off"-it zhvillohen sipas formulës, i pari



ndaj të katërtit dhe i dyti ndaj të tretit. Plasmanin në finale e siguron ekipi që i pari arrin tri fitore.

Gjysmëfinalët zhvillohen sipas formatit 2-2-1 dhe epërsinë e terrenit vendës e ka ekipi më lart i plasuar në edicionin e rregullt. Në finale të "play-off"-it takohen ekipet fituese të gjysmëfinaleve. Kampion i Superligës shpallet ekipi që i pari arrin tri fitore. Finalja e "play-off"-it zhvillohet sipas formatit vajtje-ardhje. Përparësinë e terrenit vendës e ka skuadra që ka qenë më mirë e ranguar në edicionin e rregullt dhe luan si vendës në ndeshjen e parë dhe të tretë dhe ndeshjen eventuale të pestë.

SHKURT

Berisha: Goli në gërrshërë, më i miri që kam shënuar

Sulmuesi Besart Berisha ka insistuar se goli me gërrshërë ndaj Adelaide Unitedit, i cili ia siguroi Melbourne Victorys kalimin në gjysmëfinale të A-League në fundjavë, ishte më i miri në karrierën e tij. Berisha realizoi gol me gërrshërë në minutën e 89, duke ia siguruar fitoren Melbourne 2-1. "Personalisht mendoj se ky ishte goli më i mirë që e kam shënuar ndonjëherë. Po ashtu, është goli im i parë që kam shënuar në këtë mënyrë. Është një gol që nuk e shënon shpesh në karrierë, ndoshta kurrë", ka thënë Berisha.

Sharapova: Nuk do të bëhem kurrë mike me Serenën

Maria Sharapova dhe Serena Williams janë të njohura në botë për marrëdhënien aspak të mirë. Asnjëherë mes dy kampionëve të këtij sporti nuk ka rrjedhur një bashkëpunim, gjë që është konfirmuar sërish nga tenistja ruse. "Në vite shumë gjëra janë thënë për marrëdhënien tonë, por ne duhet të gjykojemi për atë që kemi arritur. Ne kemi gjetur rrugë të ndryshme për të shkuar te suksesi dhe të dyja ia kemi dalë mbanë", u shpreh tenistja ruse, që ka fituar vetëm 2 nga 21 përballjet që ka zhvilluar ndaj Serena Williamsit. Më tej, bukuroshja ruse shtoi: "Unë kam shumë respekt për Serenën, për atë që ajo ka arritur dhe për aftësinë që ka për të luftuar ende për të shkuar te sukseset. Ajo është një teniste e veçantë. Unë kam shkruar për të në autobiografinë time, duke e vlerësuar për atë që ka arritur". Në lidhje me faktin nëse ndonjë ditë do të bëhen mikesha, pasi të kenë lënë sportin, rusja shprehet: "Nuk besoj. Kam bërë shumë miq në jetën time sportive të cilët janë të rëndësishëm për mua. Në fund të ditës, ne do të jemi gjithnjë rivale. Kemi qenë rivale që nga dita e parë dhe kjo nuk ka për të ndryshuar kurrë", ka deklaruar Sharapova.

"France Football" i kërkon falje Iniestës që nuk ia dha "Topin e Artë"

Andres Iniesta me shumë mundësi do ta mbyllë aventurën me Barcelonën pas përfundimit të këtij sezoni dhe për këtë arsye, "France Football" i ka kërkuar falje kapitenit të katalanasve për faktin se nuk e ka vlerësuar kurrë me çmimin "Topi i Artë". Njëpërjet një editoriali të kryeredaktorit të saj, Pascal Farre, revista mbulon me lavde mesfushorin spanjoll dhe thekson se emri i tij është një mungesë e dhimbshme në listën e gjatë të fituesve të çmimit më të rëndësishëm individual në futboll. Në vitin 2010 dukej se Iniesta mund ta fitonte, pasi arriti çdo sukses të mundshëm me Spanjën dhe Barcelonën, por Topi i Artë i shkoi Messit. "Iniesta nuk është një lojtar, është LOJTARI! Pa të, Messi me shumë mundësi do të ishte lodhur nga Barcelona. Talenti i tij ishte shpikja. Altruizmi ndoshta ka bërë që t'i privohen çmimet individuale. Në vitin 2010 u rendit i dyti për Topin e Artë dhe në vitin 2012 u rendit i treti. Mes emrave të mëdhenj që mungojnë në listën e Topit të Artë, emri i Iniestës është ai që vret më shumë", shkruan Farre.

Houstoni, një fitore larg gjysmëfinaleve

HOUSTON, 24 PRILL - Houstoni ka fituar 119-110 ndaj Minnesotës në ndeshjen e radhës çerekfinale të "play-off"-it në Konferencën e Perëndimit, duke udhëhequr 3-1 me ndeshje. Pas një pjese të parë të ekuilibruar, në të dytën erdhi shkëputja e skuadrës së Houstonit, që triumfoi falë 36 pikëve të James Hardenit dhe 25 të Chris Paulit, një dyshe që bëri diferencën në parket. Për Minnesotën u dallua Townsi me 22 pikë e 15 rebaunde, por që mbetën për statistikë. Surprizon sërish ekipi i Utah Jazzit, që mundi 113-96 Oklahomën, duke udhëhequr 3-1 serinë e ndeshjeve në Perëndim. Një takim me dy pamje, më e mirë për Oklahomën në pjesën e parë, me George që realizoi 32 pikë, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Për Jazzin, të pesë titullarët realizuan mbi 10 pikë, me Mitchellin që realizoi 33 pikë e Ingles me 20, duke e merituar fitoren.



KONFERENCA E LINDJES

1-8 Toronto - Washington (barazim 2-2 me ndeshje)
2-7 Boston - Milwaukee (barazim 2-2 me ndeshje)
3-6 Philadelphia - Miami (3-1 me ndeshje)
4-5 Cleveland - Indiana (barazim 2-2 me ndeshje)

KONFERENCA E PERËNDIMIT

1-8 Houston - Minnesota 119-110 (3-1 me ndeshje)
2-7 Golden State - San Antonio (3-1 me ndeshje)
3-6 Portland - New Orleans (0-4 me ndeshje)
4-5 Oklahoma - Utah Jazz 96-113 (1-3 me ndeshje)

Materazzi: Interi duhet ta mposhtë Juventusin

Marco Materazzi beson se Interi do ta mposhtë Juventusin në duelin e së shtunës në "Giuseppe Meazza". Ish-mbrojtësi italian ka thënë se "Nerazzurrët" kanë arsye të dyfishtë për të fituar në

"Derby d'Italia". "Interi do të fitojë ndaj Juventusit. Interi nuk bën ta humbë këtë mundësi për të bërë një hap të rëndësishëm drejt rikthimit në Ligën e Kampionëve dhe për t'ia komplikuar rrugën

drejt 'Scudettos' një rivali historik si Juventus. Nëse ata nuk fitojnë në Milano, rrezikojnë ta humbin pozitën e parë dhe do të jetë gëzim i dyfishtë për tifozët e Interit", ka thënë Materazzi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Duke u bazuar në dispozitat e ligjit me nr.04/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, nenit 20 paragrafi 1 të ligjit me nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 5 paragrafi 1 shkronja d, të ligjit me nr.03/L-068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës si dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ me nr.08/2014 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit nëpër shkolla, Drejtoria e Arsimit-Komuna e Prizrenit, shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Nr. 01-111-58856
Datë: 24.04.2018

Drejtoria e Arsimit

Titulli i vendit të punës : Drejtor i Shkollës Fillore
në:

- SHFMU "Lidhja e Prizrenit" - Prizren
- SHFMU "Abdyl Frashëri" - Prizren
- SHFMU "Dëshmorët e Zhurit" – Zhur, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Vëllezërit Frashëri" – Planejë, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Sinan Thaqi" – Zojzë, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Mic Sokoli" – Lybeqevë, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Dy Dëshmorët" – Piranë, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Dëshmorët e Vërrinit" – Billushë, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Zenun Çoçaj" – Gjonaj, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Nazim Kokollari" – Dardani, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Brigada 125" – Medvec, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Meto Bajraktari" – Reçan, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Planjane" – Planjane, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "25 Maji" – Lubinje e Poshtme, Komuna e Prizrenit
- SHFMU "Izvor" - Lubinje e Epërme, Komuna e Prizrenit

Pozita: Jo karrierës
Numri i Pozitave : pesëmbëdhjetë (15) pozita
Kategoria Funktionale: Niveli drejtues 1
Grada e vendit të punës: 7
Koeficienti: 7.8
Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet

Nr. 01-111-58863
Datë: 24.04.2018

Titulli i vendit të punës : Drejtor i Shkollës së Mesme
në:

- SHML "Luciano Motroni" - Prizren
- SHML "Gjon Buzuku" - Prizren
- SHML "Lorenc Antoni" – Prizren

Pozita: Jo karrierës
Numri i Pozitave : tri (3) pozita
Kategoria Funktionale: Niveli drejtues 2
Grada e vendit të punës: 6
Koeficienti: 8.4
Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet

Qëllimi i vendit të punës:

Zhvillimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të politikave dhe procedurave standarde dhe ofrimi i shërbimeve arsimore në shkollë.

Detrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Menaxhon punën e përgjithshme të shkollës, përgatit planin zhvillimor të shkollës, cakton objektivat dhe zhvillimin e planit të punës për përbushjen e këtyre objektivave; 20%
- Menaxhon stafin e shkollës, dhe në bashkëpunim me DKA-në, organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek stafi nën mbikëqyrje, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar shërbime cilësore; 15%
